

Prend BUZHALA

THIRRMAT THELLËSORE TË DASHURISË

Katër librat e fundit letrarë të Besim Xhelilit, që i botoi këtë vit (romani "1803", si dhe librat poetikë "Besa", "Dallgë në zemër" dhe "Sy të pafajshëm..."), kryekëput trajtojnë një tematikë unike: atë të dashurisë. Dhe Besimi dëshiron ekskluzivisht të jetë krijues letrar i dashurisë. Poet i dhuntive të kësaj ndjesie, i lumturimeve dhe haresë që t'i dhuron dashuria.

I. PSIKOLIRIKA, ZEMRA E HAPUR

Te ky vëllim (që mban një titull të metaforikes engjëlllore "Sy të pafajshëm..."), ai i drejtohet, si në librat tjerë, qenies që do, të dashurës. Dhe kjo thirrme drejtuar ndjesive të tij, mendjes dhe zemrës së erosit, përplaset midis dy realiteteve, largësisë së kësaj qenieje dhe përgjërimeve të përmallshme, kujtesës, shpesh trajtën e klithmës, kurse poezia merr trajtën e një psikolirike të situatës emocionale, në të cilën gjendet protagonistin a folësin lirik që ligjëron në veten e parë. Është po ajo ndjesi që ligjëron tej fushë-hapësirave të arsyes, sikur ngjitet në lartësitë sublimë të ekzistimit, një si kulm jete e gjallimi. Ai ligjëron me zemër të hapur, se asisoj dhuron dhe dhurohet, merr dhe jep:

*Nga unë ke çka të marrësh, më të fortën
Më natyroren, të fshehtë e të çiltrën*

Ndryshe, lumturimi e kënaqësia as nuk mund të përjetohen. Ato kanë burime hyjnore, që nuk shterojnë asnjëherë, prandaj

dhe frymëzimet janë të tilla, të pashtershme; dhe ndjesia dashurore është e tillë, që nuk pakësohet, dhe vetëm sa shtohet:

As që e di pse të shoh ndryshe, aq të bukur (...)
Krijuesi i botëve më ka vënë në një provë
Pak nga pak ma shton dashurinë për ty,
Andej imagjinatës më përkundin melankolitë

Pothuajse, tek të gjithë librat e deritashëm poetikë kushtuar dashurisë, ky subjekt ligjëron me unin e tij intim, personal, kurse ligjërimet e pashtershme i drejtohen femrës së dashuruar, e cila nuk paraqitet duke kuvenduar, kurse pamja, bota e brendshme a fjalët e saj, përthyhen vetëm si jehona që ngjallin mall e kujtime, që ngjall kënaqësi a grishje për ta ripërjetuar e ringjallur pafundësisht këtë ndjesi. Si ringjallje e atyre pamje-ndjesive në kujtesë, si shfaqje e këndshme dhe tërheqëse që e mrekullon atë:

Dashuria për ty më mban gjallë, o e shtrenjta mike
Pranë teje ndodhin mrekullitë në zemrën time...

apo si freski jetës. Mu ashtu si do të thoshte Pablllo Pikaso: “*Dashuria është freskia më e madhe e jetës.*” Nga ana tjetër, ky subjekt i këndon lektisje-vuajtjet e tij, përmes kësaj trajte të psikolirikës së mërzisë, ankthit: “*Plot ethe në zemër jam...*”; “*Ankthi më përmbys shpirtin e lodhur, sa larg që je.*” ...). Përmasat e kujtimit shtrihen nëpër gjithë librin (“*Pse ma thyejnë kokën këto kujtime të largëta*”). Më shumë se sa një koncept semantik poetik, kujtimi është shprehje lirike e situatave në të cilat gjenden protagonistët lirikë (“*Pse ma*

thyejnë kokën këto kujtime të largëta,/ Natyra ka marrë pamjen e një bukurie të shëmtuar.”) Gjithsesi, që vënia në gërshet e këtyre dy përqasjeve, sikur e përfill konceptin poetik të hapjes së zemrës së dashurisë... ajo, zemra, mund të thyhet, të dashuruarin mund ta kaplojë pikëllimi a mosdurimi, mërzia apo trishtimi, ankthi a thyerjet e brendshme (“*Tani bërtas si i çmendur rrugëve të ligësisë*”)... porse mu në këso gjendjeje të brendshme, mu kur lëndimet kanë prekur zemrën e tillë, mu aty ndjehet tensioni, trysnia a shtrëngesat e kësaj ndjesie për ta përjetuar më plotnisht atë.

Assesi nuk ka mundësi të çlirohet nga ky obsesion, përkundrazi lektiset sa më shumë për ta shtuar këtë ndjesi, dhe mikja i bëhet ngarkesë e ekzistencës, sepse ajo është **esencë e ekzistimit**.

2. KËNGA E NJË POETI

Shpesh, ky **folësi lirik**, identifikohet me vetë **poetin**, ata janë e njëjta qenie, mishërim i njëri-tjetrit. Te poezia “*Poet i çmendur*”, duket sikur ata janë dy qenie (gjithnjë për poetin folësi lirik ligjëron në veten e tretë), por pas pak vargjesh shfaqet uni i po këtij folësi lirik që ligjëron për qeniet që dashurohen:

*Ditën një poet i çmendur të argëton
Vargu i tij në veshë qetë të tingëllon,
Natën mes kusarëve gjen kënaqësinë
Me ata që s'kanë shije për dashurinë.*

*Dashuria ime për ty dhimbje ka
Është e fortë dhe e përhershme*

Në këndimet e tilla lirike poeti nuk njeh moshë, mu ashtu si nuk i numëron vitet vetë dashuria. Së këndejmi, sa herë ai lëshon thirrmenë e tij poetike për ta qasur pranë vetes të dashurën, ajo dashuri lind, ngjallet e ringjallet. Dhe një poet nuk mund të përfytyrohet pa dashurinë. Madje, të gjithë librat e tillë, që të katërtit (roman e poezi), janë këngë për dashurinë, janë “*Kënga e një poeti*”:

*Eksodi i shpirtit tim në një botë humnerash
Nga tortura e ditëve zemrën do t'ma shpëtonte...
Bëra mirë që në ty u dashurova aq fortë
Nga kjo ndjenjë marr një gjallëri për jetën...*

Madje, ai dashurohet me një pasion përtej jetës (“*Si ta kujtosh një poet që vdiq i dashuruar/ Për një varg nga zemra jote gjej pak forcë*”), madje dhe përtej vdekjes (poezia “*Më mbyt dhe bëhu e lumtur*”). Dashuri është vetë jeta. Ajo është mall, është pasion, është pafajësi virgjërore, është valë dhe mall, është dallgë, mu ashtu si ta sugjerojnë dhe vetë tituj e dy cikleve të librit: “*Sy të pafajshëm, por që lëndojnë*” dhe “*Dallgë mendimesh.*”

Kënga për dashurinë, për poetin, është dhe një llogaridhënie e ndërgegjegjësimit jetësor: për ta shikuar situatën në të cilën gjendet, për të reflektuar për hapat që ka bërë në jetë, me besimin se është dashuria ajo që shpëton gjithçka në jetë dhe i jep kuptim jetës.

3. PAFUNDËSIA, HIRI I PERËNDISHËM

Sflitjet për ta pushtuar këtë ndjenjë, janë të pafund, sepse asisoj ai e ndien se bëhesh një me shpirtësinë e ndritshme të jetës, një dritë që të pushton tërësisht, dhe kur jeton dhe ekziston vetëm në gjendjen pothuajse pa trup, si qenie fluide... shndërrohesh i tëri në dashuri... Porse poeti nuk shkon aq larg për t'i dhënë tis metafizik dashurisë, sado që nuk e shkëput asnjëherë nga hyjnorja, nga hiri i perëndishëm, apo dhe nga burimet mrekullibërëse mitologjike:

*Ja ku merr frymë shpirti im nëpër mitologji
Nëpër kalldrëmet e ngushta lëvizin hijet e lashta
Të heronjve, të perëndive e të dashuruarve
Dhe mua dashurinë për ty ma shtojnë plot dritë*

Vetëm sa e ndien këtë hapësirë metafizike, nëpërmes konceptit të pafundësisë, si metaforë e dashurisë asnjëherë të harxhuar. Kjo pafundësi është dhe vetëzberthim, njohje e skutave të ndjesive të panjohura, një kërkim që nuk pushon asnjëherë në zberthime e kundërime të vetes, vetënjohjes, mu ashtu si ka etje të pafund poeti për ta kundruar, përjetuar e perceptuar ndjesinë e dashurisë, si hapësirë kurrë e eksploruar përfundimisht. Prandaj dhe poeti shkruan, libër pas libri për dashurinë. Sorin Cerin do të thoshte: "Vetëm në sytë e dashurisë ju mund të gjeni pafundësi." Kurse Gustav Flober në letrat e tij shprehet: "Vetëm tre gjëra janë të pafundme: qielli në yjet e tij, deti në pikat e tij të ujit, dhe zemra me lotët në sytë e saj ". Folësi lirik e ndien këtë pafundësi, si pafundësi pasioni, si mishërim me shkëndijëzimet hyjnore:

*Merrma tani dorën dhe të nisemi atje në pafundësi
Nga vijnë dritat hyjnore të dashurive të përjetshme,*

Sinonim i dashurisë është përjetësia. Pastërtia e ndjenjës, virgjëria e fjalëve dhe frymëzimeve. Madje, poetët, që në zanafillë, e kanë hetuar se nëpërmes ndjesisë së dashurisë më thellë e më bukur hulumtohet e gjurmohet vetë universi. Le ta kujtojmë Lasgushin tonë të madh që ndërtoi një sistem poetik kozmogonik mbi paradigmat e dashurisë.

Besim Xhelili, nga libri në libër arrin ta thellojë e të kundrojë lirikën e dashurisë nga shumë anë, nga burime të shumta frymëzimesh, nga këndvështrime gjithnjë e më të pasura përjetimesh dhe domethëniesh, nga nuancime situatash emocionale shpesh të befasishme e të gjetura. Dhe kërkimi i tillë e arsyeton edhe nivelin artistik të këtyre lirikave.

Korrik 2016